



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Selmans Network" Sh.P.K. të datës 28.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 22.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e parkut të lodrave në lagjen Ulpiana" me nr. të prokurimit 616-23-6462-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Selmans Network" Sh.P.K. të datës 28.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 22.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e parkut të lodrave në lagjen Ulpiana" me nr. të prokurimit 616-23-6462-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Selmans Network" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Selmans Network" B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 28.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 22.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e parkut të lodrave në lagjen Ulpiana" me nr. të prokurimit 616-23-6462-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë se tenderuesi i rekomanduar për kontratë “NTP Lulishtja Buqaj & Metropolis Geo Sh.P.K” nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional konkretisht kërkesën nr. 4 për arsyt si në vijim:

- “nuk ka dorëzuar asnjë certifikatë ISO EN”;
- “ deklarata e garancionit të produktit është e lëshuar nga MELOS GmbH për një kompani që as nuk është pjesë e asnjë marrëveshje me pjesëmarrësit ne këtë procedurë”;
- Deklarata e garancionit në emër të Melos GmbH është e lëshuar nga Interplast Muh. Plastikleri Sanayi ve Ticaret A.S me seli në Stamboll dhe nuk është e lëshuar për instaluesin e produkteve grupit të OE N.T.P Lulishtja Buqaj dhe Metropolis Geo sh.p.k si fitues të kësaj procedure. Në të njëjtën kohë sipas garancionit Melos GmbH rezervon të drejtën e terheqjes e garancionit në çdo kohë. Ky garancion nuk kalon filtrin kryesor dhe më të rëndësishmin datën e lëshimit, nënshkrimin dhe vulën e garantuesit. Pra ky dokumnet i paraqitur si garancion sipas kërkesave të dosjes së tenderit është i lësuar me 23 qershor 2014 dhe ka kaluar secilin afat të mundshëm prej 5 viteve. Është 10 vjetë i vjetër.
- ka dështuar të dorëzoj edhe mostrat fizike të produktit gjë që këtë operatorë automatikisht e ka bërë të pa përgjegjshëm.

Pretendimet e ankimore të parashtruesit kanë të bëjnë me kërkesën nr. 4 lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional në dosjen e tenderit të përcaktuar si në vijim:

| | | | |
|--|------------------------------|---|--|
| <p>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale</p> | <p>9.1 & 9.2</p> | <p>Kapaciteti teknik dhe profesional 4. Operatori Ekonomik ose Furnizuesi i OE duhet të dorëzoje Certifikatat ISO Standarde dhe raportet e testeve që lidhen me natyrën e aktivitetit:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Certifikata ISO Standard ISO 9001 2015; •Certifikata ISO Standard ISO 14001 2015; •Certifikata ISO Standard ISO 45001 2018; •Certifikata ISO Standard ISO 50001 2018; •Certifikata ISO Standard ISO 39001 2012; •Certifikata ISO Standard EN 1176-1; •Certifikata ISO Standard EN 1176-2+AC; •Certifikata ISO Standard EN 1176-3; •Certifikata ISO Standard EN 1176-9+AC; •Certifikata ISO Standard EN 1176-11; •Certifikata ISO Standard DIN EN-71; •Certifikata ISO Standard DIN V 18035-7; •Certifikata ISO Standard DIN 18035-6; •Certifikata ISO Standard EN ISO 9227 1440; •Certifikata ISO Standard EN ISO 6270-1 720; •Certifikata ISO Standard EN ISO 12944-6; •Certifikata ISO Standard ISO 105 B02; •EN ISO 2409; •EN ISO 2178; •EN 71-3; •EN 71-2; •EN ISO 4624; <p>Produktet e gomës duhet të kenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> •Certifikatë antikancerogjene; | <p>Dëshmia e kërkuar dokumentare: 4. Kopje e Certifikatave ISO me validitet për vitin 2023.</p> |
|--|------------------------------|---|--|

| | | |
|--|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> •Certifikatë për aplikim në temperaturë -30°C deri +130°C; •Certifikatë të garancionit për min. 5 vjet; •Të plotësojë normat me raportin e testit të ndezshmërisë; | |
|--|--|--|

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, nga dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar nuk është arritur të evidentohen të gjitha çertifikatat ISO EN të cilat janë kërkuar sipas dosjes së tenderit. Prandaj pikat e pretendimit ankimor ku thuhet se nuk është dorëzuar asnjë çertifikatë ISO EN është vetëm pjesërisht e bazuar pasi që disa prej këtyre çertifikatave janë dorëzuar mirëpo mungojnë disa të tjera të cilat janë kërkuar sipas dosjes së tenderit.

Pika e pretendimit ankimor lidhur me deklaratën e garancionit dhe për aplikimin e temperaturës është po ashtu e saktë pjesërisht pasi që për parashtruesit nuk është kontestuese që janë dorëzuar këto dokumente mirëpo kontestuese është nëse këto dokumente janë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Prandaj edhe kjo pikë e pretendimit ankimor është pjesërisht e bazuar. Vlen të thuhet se komisioni vlerësues nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar lidhur me kompaninë nga e cila janë lëshuar këto dokumente dhe as për kompaninë për të cilën janë lëshuar dhe as për datën e lëshimit, nënshkrimin dhe vulën e garantuesit.

Pika e pretendimit ankimor sipas të cilit nuk janë dorëzuar mostrat e kërkuara është e pabazuar pasi që komisioni vlerësues ka konfirmuar se janë dorëzuar mostrat sipas dosjes së tenderit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.